



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 840/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Mitrovicë, paraqitur kundër Komisionerve të Vendvotimit në Mitrovicë, për shkak të paregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votim, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Mitrovicë.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 12.11.2013, në Qendren e Votimit 1114b/02D dhe 1114/01R, se në Sh.F „Harun Beka” në fshatin Gushavc në Komunen e Mitrovicës, egziston dyshimi se ka manipulim me rastin e shenimit të rezultatit përfundimtar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar**

Me ankesën e parashtruar të subjektit politik PDK, pretendohet se ka manipulim me rastin e shenimit të rezultatit përfundimtar, parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova më të cilën do të vertetohej se është kryer një veprim i tillë, andaj një pretendim i tillë u vlerësua si i pabazuar dhe ne kuptim të nenit 3.6 pika c, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 840/2013 më datën 12.10.2013.



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.